



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 448/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Muferra Srbica Sinik, kandidate për deputete nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), Dega në Mamushë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, dhe rezultatit zgjedhor, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHET** e pasafatshme ankesa Anr.448/2019, e datës 07.11.2019, e paraqitur nga Muferra Srbica Sinik, kandidate për deputete nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), dega në Mamushë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, dhe rezultatit zgjedhor, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 07.11.2019, ka pranuar ankesën Anr.448/2019, nga Muferra Srbica Sinik, kandidate për deputete nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), Dega në Mamushë, në të cilën pretendon se gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, nga ana e këtij subjekti politik janë evidentuar shkelje drastike në lidhje me këto zgjedhje në komunën e Mamushës, në cilin rast theksohet se personi i cili flet për shkeljet flagrante gjate procesit zgjedhor në një audio incizim, është njëherit kryetar i KDTP-së, i Degës së Mamushës, dhe i vetmi kandidat për deputet (Rifat Krasniq), i cili sipas paraqitësit të ankesës, për të gjithë situatën e krijuar ka qenë në dijeni dhe ka qenë nën organizimin dhe kontrollin e tij.

Paraqitësi i ankesës kërkon nga PZAP, që të merr masat e nevojshme ligjore konform nenit 26 të Rregullës Zgjedhore Nr.09/2013, për ta evituar këtë problem dhe të anulojë rezultatet e vendvotimit apo qendrës së votimit në Komunën e Mamushës, si dhe ta urdhërojë KQZ-në, të përsërisë votimet në këtë komunë, pasi që rezultatet e dala nga kjo komunë kanë pasur ndikim në rezultatet finale.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e ankesave, gjeti se:

## **Ankesa është e pasafatshme**

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda afatit prej 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit sipas nenit 119 par.1 të LZP-së. Në rastin konkret qendra e votimit është mbyllur më datë 06.10.2019 në ora 19:00, ndërsa ankesa Anr.448/2019, nga paraqitësi i ankesës është paraqitur në PZAP me datë 07.11.2019, që do të thotë pas afatit të paraparë ligjor të përcaktuar me nenin 119 par.1 të LZP-së.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart e në kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr. 448/2019 më datë 09.11.2019



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.